



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18, Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 428/14 Prot.

Tiranë, më 30.01.2017

V E N D I M

Nr.4, datë 30.01.2017

Mbi përfundimin e procedimit administrativ të nisur me urdhrin nr. 428/1 prot., datë 20.06.2016, për disa shkelje të pretenduara nga nëpunësi *** , gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për ngritjen në detyrë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenet 11/ 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 - 90 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit protokolluar pranë Komisionerit me nr. 361 prot., dt. 29.04.2016, për disa shkelje të pretenduara se janë kryer gjatë zhvillimit të një procedure konkurrimi për ngritje në detyrë,

VËREJ :

Pas njohjes me informacionin që përmbante një kërkesë e parashtruar prej nëpunësit ***** , protokolluar me nr. 428 prot., datë 02.06.2016, për disa shkelje të pretenduara se janë kryer/lejuar, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për ngritjen në detyrë, për pozicionin "Specialist në Sektorin e Hartografimit", në Drejtorinë e Gjeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Për këtë arsye, në bazë të Urdhrit nr. 428/1 prot., datë 20.06.2016 "Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa me nr. 428 prot., dt. 02.06.2016, mbi zhvillimin e konkurrimit për ngritjen në detyrë", është kryer verifikimi i këtij rasti, prej nga ka rezultuar si më poshtë:

Punonjësi ***** , duke qenë i punësuar në pozicionin "Specialist në Sektorin e Hartografimit", në Drejtorinë e Gjeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, ka marrë pjesë në konkurrimin nëpërmjet procedurës për ngritje në detyrë, për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit" në të njëjtin institucion.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, pas vlerësimit përfundimtar nga ana e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), konkurrenti *****, nuk është shpallur fitues, vendim me të cilin nuk ka qenë dakord i sipërpërmenduri dhe pretendimet e tij për paligjshmëritë e kryera/lejuara gjatë kësaj procedure, i ka bërë prezent para Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në mënyrë të përmbledhur, pretendimet konsistojnë në faktin se dy prej anëtarëve të KPND, *****, kanë qenë në konflikt interesi me konkurruesin, pasi në raste të caktuara kanë shfaqur opinione të kundërta për çështje të ndryshme shkencore nëpërmjet artikujve në fushën e gjeoshkencave (*artikuj të kundërshtuar edhe në Bordin e Redaksisë së Buletinit të Shkencave Gjeologjike, ku ***** është anëtar*) dhe se një pjesë e pyetjeve të testimit me shkrim dhe atyre të intervistës së strukturuar me gojë, kanë qenë tej përmbajtjes së tekstit të Gjeologjisë së Shqipërisë, gjë e cila ka ndikuar në cilësinë e përgjigjeve të dhëna.

Rezulton gjithashtu, se në të njëjtën kohë me kërkesën e mësipërme, konkurrenti ***** ka paraqitur ankesë edhe pranë Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, fakt ky, i cili iu bë me dije Komisionerit nëpërmjet shkresës nr. 428/6 prot., dt.07.07.2016. Mbi këtë bazë, Departamenti i Administratës Publike, me vendimin nr. 3013, dt. 09.06.2016, ka vendosur të pezullojë zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së konkurrimit, duke nisur një hetim administrativ për verifikimin e rastit.

Pas kryerjes së hetimit administrativ dhe ballafaqimeve përkatëse, me shkresën nr. 2838/5 prot., datë 23.11.2016, Departamenti i Administratës Publike ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil lidhur me konkluzionet e arritura, duke dërguar dhe një kopje të vendimit të tij me nr.3013/1, datë 01.11.2016, ku flitet hollësisht për procedurën e ndjekur dhe konkluzionet e arritura në përfundim të këtij hetimi administrativ për verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur dhe përmbajtjes së procesit të konkurrimit për ngritje në detyrë, për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit*” në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Duke analizuar hollësisht, dy pretendimet e ngritura, në këtë vendim është arsyetuar si më poshtë:

Pretendimi i parë, se dy prej pyetjeve të testimit me shkrim, si dhe dy prej pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë, kërkonin dije tej përmbajtjes së tekstit Gjeologjia e Shqipërisë, nuk është konsideruar i drejtë pasi fusha e njohurive e përcaktuar në shpallje dhe literatura e rekomanduar, ka qenë më e gjerë dhe nuk bazohej vetëm në tekstin e Gjeologjisë së Shqipërisë.

Po kështu, i pabazuar është konsideruar edhe pretendimi i dytë, për ekzistencën e një situate të mundshme konflikti interesi me ***** dhe ***** , anëtarë të Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë. Pretendimi se ndërmjet tyre ka patur kundërshti në pikëpamje të ndryshme shkencore në fushën e gjeoshkencave dhe se kjo mund të ketë ndikuar në vlerësimin nga ana e KPND, nuk është vlerësuar se mund të përfshihet në një nga rastet e konfliktit të interesit të parashikuara në nenin 30, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Pasi u njoh me vendimin e mësipërm, Komisioneri vazhdoi hetimin administrativ të nisur prej tij, lidhur me pretendimet për shkelje ligjore gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit, si në kuadër të dy pyetjeve të testimit me shkrim dhe të intervistës së strukturuar me gojë, që pretendohen se janë jashtë përmbajtjes së tekstit zyrtar të Gjeologjisë së Shqipërisë, ashtu dhe në

drejtim të konfliktit të interesit të pretenduar, me dy prej anëtarëve të Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë, të trajtuara edhe nga Departamenti i Administratës Publike në vendimin e tij.

Në përfundim të analizës së kryer, rezultoi se në kryerjen e procesit të këtij konkurrimi, nga pikëpamja procedurale ishin zbatuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”* të Këshillit të Ministrave dhe në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese...”* të Departamentit të Administratës Publike.

Pretendimi se dy prej pyetjeve të testimit me shkrim dhe dy pyetje të intervistës së strukturuar me gojë, nuk gjendeshin në tekstin e Gjeologjisë së Shqipërisë, është i pabazuar, pasi fusha e shpallur e njohurive, që duhet të ketë kandidati pjesëmarrës në konkurrim, është më e gjerë se ky tekst. Konkretisht, sipas shpalljes, kandidati duhej të kishte njohuri të plota për gjeologjinë e Shqipërisë, njohuri për zonat tektonike, njohuri për eurokodet në fushën e hartografimit, kondicionet e hartografimit në shkallë të ndryshme, etj. Nisur nga sa më sipër, me të drejtë është vlerësuar i pabazuar shkencërisht dhe ligjërisht, arsyetimi i konkurrentit *****, se pyetjet e konkurrimit duhej të ishin vetëm brenda njohurive të përfshira në tekstin në fjalë.

Edhe pretendimi i ngritur, se dy prej anëtarëve të Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë ishin në konflikt interesi me konkurrentin *****, vlerësohet i pambështetur në ligj.

Anëtarët e Komisionit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) janë përzgjedhur rregullisht, në bazë të Kreut III *“Ngritja në detyrë”*, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”* të Këshillit të Ministrave. Nga ana tjetër, në analizë të përmbajtjes së nenit 30, *“Pengesat ligjore”*, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, rasti në fjalë nuk përfshihet në asnjë nga rastet e konfliktit të interesit, të parashikuara në këtë dispozitë ligjore, prandaj si i tillë, nuk mund të merret parasysh.

Në përfundim të analizës së fakteve, arrihet në konkluzionin se procedura e rekrutimit për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit”*, në Drejtorinë e Gjeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, është e mbështetur në ligj dhe është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, me Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”* të Këshillit të Ministrave, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”* të Departamentit të Administratës Publike.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ligji nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 e 34, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të kryer në bazë të urdhrit të verifikimit nr. 428/1 prot., datë 20.06.2016, për verifikimin e pretendimeve të parashtruara nga nëpunësi ***** , në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit nëpërmjet ngritjes në detyrë në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Hartografimit”, në Drejtorinë e Gjeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.
2. Të njoftohen për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe nëpunësi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA